

## Jonida CUNGU

### GJUHA PËRBALLË NDIKIMIT TË DUKURISË SË MONOSEMISË

**Abstrakti:** *Kuptimi i fjalës shfaq interes për zgjidhjen e disa çështjeve të diskutueshme të semantikës. Natyra e lidhjes së fjalës me kuptimin tregon për karakterin e ndërlëkuar të kuptimit të fjalës. Dyshimi, nëse fjalët kanë shumë kuptime apo vetëm një kuptim, të cilin e përdorim në kontekste të ndryshme, është ende tematikë që trajtohet nga studiues të shumtë.*

*Ky punim ka për qëllim të trajtojë çështje të kuptimit të fjalës dhe të përshkruajë ndikimin e monosemisë përballë gjuhës, duke pretenduar se fjalët me një kuptim zënë një vend të konsiderueshëm në leksik. Edhe pse konsiderohet si një fenomen i rrallë gjuhësor, për shkak të numrit të vogël të fjalëve njëkuptimëshe krahasuar me fjalët shumëkuptimëshe, do të përpiqemi të argumentojmë pse monosemia duhet trajtuar si dukuri gjuhësore. Përmes trajtimit teorik dhe nëpërmjet hulumtimeve në "Fjalor i gjuhës shqipe" 2006, pretendojmë të argumentojmë jo vetëm shtimin e fjalëve njëkuptimëshe në gjuhën shqipe, por edhe ndikimin e tyre në gjuhë për shkak të strukturës së varfër semantike që ato paraqesin.*

*Metodat sasiore, cilësore, si dhe analiza krahasuese do të shërbejnë për të evidentuar mënyrat e përfutimit të monosemisë në gjuhën shqipe, natyrën e vakët përmbajtjesore të strukturës leksikore të fjalëve njëkuptimëshe, vlerën që monosemia merr përballë gjuhës.*

**Fjalë kyç:** *monosemi, dukuri gjuhësore, huazim, strukturë, njësi leksikore.*

#### Trajtime teorike mbi dukurinë e monosemisë

Lëvizjet kuptimore të strukturës së fjalës janë studiuar gjerësisht për shkak të diskutimeve që shfaqin. Në rrjedhën e ndryshimeve semantike në përmbajtjen leksikore, fjalët bëhen shkak për dukuri të ndryshme gjuhësore. Një nga këto fenomene është dhe monosemia ose njëkuptimshmëria. Qëllimi i punimit është të përshkruajë monoseminë dhe të krahasojë ndryshimin e fjalëve monosemantike në fjalorët shpjegues të shqipes. Konkluzionet e përfutura do të shërbejnë për të treguar shtimin e fjalëve monosemantike në leksikon e gjuhës shqipe, mënyrat e përfutimit të monosemisë, ndikimin e monosemisë në gjuhë, si dhe një perceptim ndryshe në trajtimin e monosemisë si dukuri gjuhësore.

Nëse fjala ka një kuptim apo varg kuptimesh, të cilat i përgjigjen një ose disa koncepteve, është dilema që po trajtohet gjerësisht nga studiuesit në fushën e semantikës. Qasjet rreth perceptimit të monosemisë janë të ndryshme. Teoria e semantikës konjitive thekson se kuptimet e ndryshme të fjalës, u përgjigjen koncepteve të ndryshme. Sipas kësaj pikëpamjeje, jemi në diskutimin nëse shumëkuptimësia e fjalëve është e qenësishme apo jo. Studiues si Nunberg, Klein dhe Murphy, mbështesin mendimin se monosemia lidhet me parimet pragmatike, duke u fokusuar në përcaktimet kontekstuale. Pra, ka disa parime që luajnë rol në zgjerimin apo jo të përmbajtjes së

një fjale.<sup>1</sup> Ato mendojnë se kuptimet e një fjale përcaktohen nga konteksti në të cilin përdoret njësia leksikore.

S.A.Rice e konsideron monoseminë si një hipotezë, që mbështetet në mendimin se shumica e njësive leksikore kanë vetëm një kuptim. Në këtë mënyrë monosemia vendoset përballë dy dukurive të tjera: polisemisë dhe homonimisë, që mundësojnë shumë kuptime të jenë në një formë të vetme leksikore<sup>2</sup>.

Një qasje të re për perceptimin e monosemisë sjell Ch.Ruhl, i cili e trajton dukurinë si polemikë në gjuhësi. Ai mendon se çdo fjalë ka vetëm një kuptim, pasi çdo koncept i përgjigjet një referenti. Në këtë trajtim ai përjashton vetëm homoniminë. Ndërsa debatin për poliseminë dhe monoseminë, i shpjegon si dy dukuri që janë një mosmarrëveshje semantike<sup>3</sup>.

Gjithashtu Ch.Ruhl mendon se, monosemia në vetvete mund të jetë polisemi. Sipas këtij argumentimi, nëse do t'i referoheshim trekëndëshit semantik të fjalëve (kompleks tingullor-koncept-referent), atëherë çdo variant kuptimor (që në fakt përfaqëson një përdorim të fjalës) të krijon idenë se kemi të bëjmë me fjalë të ndryshme, pasi ato i përgjigjen një referenti. Pra, janë fjalë që praktikisht konsiderohen si përdorime në variante kontekstore të ndryshme dhe jo variante semantike të ndryshme. Edhe pse Ruhl është kundërshtuar nga disa studiues, shpjegimi që sjell për dukurinë e monosemisë nëpërmjet realizimit të testeve të veçanta të polisemisë, mbetet i vyer dhe interesant, i cili do të përdoret si analogji dhe në shembujt e shënuar më poshtë.

Çështje të lëvizjes kuptimore janë trajtuar gjerësisht dhe nga studiuesi J.Thomai, i cili pranon se në leksikon e gjuhës shqipe pasqyruar në fjalorin shpjegues të 1980-ës, rreth 80% e fjalëve dalin më me shumë se një kuptim<sup>4</sup>. Trajtimi i monosemisë (apo fjalëve njëkuptimëshe) është prekur pak, duke u trajtuar më dendur dukuria e polisemisë. Është bërë një përpjekje për të llogaritur vlerën e polisemisë për fjalët e pasqyruara në fjalor, duke përmendur se numri i fjalëve polisemantike është rreth 80%, duke marrë parasysh se edhe shumë prej fjalëve njëkuptimëshe janë të prejardhura semantikisht e historikisht. Në këtë mënyrë përlllogaritet se rreth 20% e fjalëve të leksikut të shqipes referuar fjalorit shpjegues, janë fjalë monosemantike.

Mënyrat e përfutimit të monosemisë dhe pasqyrimi i tyre në fjalorët shpjegues

Fjalë monosemantike (apo njëkuptimëshe) janë konsideruar fjalët, të cilat kanë vetëm një kuptim. Kjo do të thotë se struktura përmbajtësore e tyre, është e organizuar rreth një kuptimi të vetëm. Fjalët janë njësi të ligjërimit, të cilat i përgjigjen komunikimit. Nga ana tjetër, ato pasqyrohen si njësi leksikore në fjalor me një apo disa kuptime. Por në ligjërime, njësitë leksikore duhet të konsiderohen monosemantike, pasi i përgjigjen vetëm një referenti. Pavarësisht se fjalët

---

<sup>1</sup> V.R.Verhoeven, "The organization of the mental lexicon", fq.7-9.

<sup>2</sup> Sally A. Rice, "Polisemy and lexical representation".

<sup>3</sup> Ch.Ruhl, "On monosemy. A study in linguistics semantic", 1989, University of New York Press.

<sup>4</sup> J.Thomai, "Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe", fq.77, Tiranë 2009.

mund të kenë disa kuptime, gjatë përdorimit të tyre ne i referohemi vetëm një kuptimi (kuptimit të fjalës që del nga konteksti). Në të kundërt komunikimi do të ishte konfuz dhe i pamundur.

Ky punim kërkon të ngrejë pikëpyetje, të cilat mund të jenë objekt i disa diskutimeve, si psh: sa fjalë konsiderohen monosemantike në gjuhën shqipe? A duhet të konsiderohet monosemia krahas sistemeve semantike themelore si: polisemia, homonimia, sinonimia, antonimia? Deri ku shkojnë kufijtë e polisemisë? Cilat janë mënyrat e përfutimit të polisemisë? Për këtë qëllim është përdorur metoda krahasuese midis fjalorëve shpjegues të shqipes dhe metoda analizuese për realizimin e studimit.

Nga vjelja e materialit në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 rezulton se monosemia paraqet vlera të tjera, duke shënuar rritje për shkak të hyrjeve të njësive leksikore monosemantike. Afro 25% e fjalëve të pasqyruara në fjalor janë monosemantike. Pra, rreth 12.000 njësi leksikore kanë një kuptim të vetëm. Edhe nëse një fjalor i ri do të hartohet, mendojmë se numri i fjalëve njëkuptimëshe do të ishte akoma dhe më i madh. Ka disa arsye:

-gjuha shqipe është vënë përballë një shpërthimi huazimesh, strukturat përmbajtëse të të cilave janë më së shumti me një kuptim të vetëm. Fjalët e huazuara janë hyrje edhe si zë leksikor, ku të gjitha njësitë e zërit leksikor ruajnë natyrën monosemantike. Kjo bën që nga ana sasiore të kemi një rritje të konsiderueshme të monosemisë. Psh: abrogoj, aksesor, akuadrom, aleancë, celular, central, diversionizëm, defekt, definitiv, dimensionoj, dislokoj, divorcoj, fetarizoj, indeks, indeksoj, indinjoj, indinjatë, independencë, independent, internet, masmedie, master, medie, mocion, nudist etj<sup>1</sup>.

-duke qenë se gjuha shqipe u desh të përballonte në dhjetëvjeçarët e fundit zhvillimet e vrullshme në jetën shoqërore, kulturore, ekonomike, politike etj, u gjet përballë hyrjeve të njësive leksikore nga fusha e teknologjisë. Në pamundësi të përgjegjëseve shqipe, gjuha asimiloi një sërë hyrjesh të reja leksikore, të cilat janë kryesisht fjalë terma. Ato kanë karakter monosemantik dhe sferë përdorimi tepër të kufizuar. Kjo sjell pritshmëri të ulët, që këto fjalë të gjenerojnë variante të tjera kuptimore në strukturën përmbajtëse, për shkak të natyrës së ngurtë kuptimore që paraqesin dhe pamundësisë për t’u përdorur në sfera të tjera përdorimi. Psh: alto-ja, allahu, ambulant, antigaz, biplan, dividant, debi, decentralizoj, detektiv, djegore, interpelancë, legjislacion, marketing, marijuanë, mason, klikoj, klonoj, nevrus, matem, maus, vetratë, xhin, skaner etj.

-pasurimi i leksikut nga fjalët dialektore ka bërë të mundur hyrjen e njësive leksikore në fjalor, të cilat janë monosemantike. Përdorimi i tyre në një territor të kufizuar, nuk i ka dhënë mundësi strukturës përmbajtëse të fjalës që të gjenerohet me variante të tjera kuptimore. Krahinorizmat konsiderohen si “...dublete ose sinonime dialektore të qarta të fjalëve që gjenden

---

<sup>5</sup> “Fjalor i gjuhës shqipe”, Tiranë, 2006.

në normën letrare...<sup>1</sup> dhe sinonimet e tyre kanë më tepër gjasë të zhvillojnë përmbajtjen kuptimore se vetë krahinorizmat. Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e fjalëve dialektore hyjnë si njësi leksikore monosemantike, duke shënuar rritje të dukurisë së monosemisë. Psh: biban, bic, biculë, birko, bishtalugu, blec, bollko, bolloboçkë, gaç, gandall, ferishte, firajkë, komshi, mëmëzonjë, mëtini, mëzor, milor, mixhë, sallator etj.

-në fjalorin shpjegues të 2006-ës gjenden një sërë fjalësh të cilat kanë lëvizje të strukturës përmbajtësore, duke kaluar nga fjalë polisemantike në fjalë monosemantike. Ndryshimet në kuptimin e fjalëve kanë ndodhur për shkak të shmangies nga përdorimi të disa varianteve kuptimore të fjalëve, ose bashkimit të varianteve kuptimore të një fjale në një kuptim të vetëm. Në vijim të argumentimit të Ch.Ruhl, krahasojmë fjalën “mëkatoj” në dy fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe.

Në “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” 1980 kemi këtë paraqitje: mëkat/oj jokal., ~ova, ~. 1.fet. Shkel rregullat e porosinë fetare, veproj kundër dogmës fetare e kundër rregullave të kishës, bëj mëkat, bie në mëkat. 2.bised. Shkel një rregull a diçka të ndaluar, bëj faj; bëj një veprim të turpshëm a të dënueshëm.

Në “Fjalor i gjuhës shqipe” 2006 kemi këtë paraqitje: mëkat/oj jokal., -ova, -uar bëj një mëkat, bie në mëkat.

Fjala -mëkatoj- ka shërbyer për të treguar veprimin e kryerjes së mëkatit dhe kryerjen e gabimit. Ndërsa më vonë, variantet kuptimore shkrihen për shkak të afërsisë së madhe semantike që kanë (shpërbërja e polisemisë) dhe kemi një fjalë monosemantike. Shkrija apo bashkimi i varianteve kuptimore në një të vetëm ka ndodhur në rreth 300 njësi leksikore të pasqyruara në fjalorët shpjegues, shkak i cili jo vetëm rrit numrin e fjalëve monosemantike, por ngre dhe pikëpyetjen nëse kemi patur të bëjmë me polisemi apo monosemi.

Por, monosemia paraqet dhe paqëndrueshmëri të strukturës kuptimore. Shumë fjalë mund të qëndrojnë për një kohë të gjatë monosemantike e më pas ndryshojnë strukturën e tyre leksikore. Ka edhe njësi leksikore të huazuara, të cilat janë pjesë e një sfere të caktuar të teknologjisë apo jetës shoqërore, por i kanë kapërcyer kufijtë e përdorimit në një shkallë më të gjerë, duke kaluar nga sfera e ngushtë e leksikut profesional, në atë të leksikut më të përgjithshëm. Psh, fjala -divorc- paraqitet në “Fjalorin e gjuhës shqipe” 2006 si: divorc,-i m. sh. -e(t) libr.zgjidhje e martesës, ndarje. Tashmë është filluar të përdoret në diskurse të ndryshme dhe kuptimi “divorc politik”. Do të vërejmë, nëse në të ardhmen ky përdorim do të pasqyrohet në fjalorët shpjegues si variant kuptimor ose jo.

Polisemia dhe homonimia janë fenomene gjuhësore që qëndrojnë në opozicion me njëra-tjetrën. Nëse do të huazonim termin e dhënë nga N.Riemer, ato konsiderohen si dikotomi gjuhësore<sup>2</sup>.

<sup>6</sup> A.Kostallari, “Parimet themelore për hartimin e “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, në “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, Tiranë 1972, fq.67.

<sup>7</sup> Nick Riemer, “The semantic of polisemy”, Cognitive Linguistic Research, 2005, fq.120. "

Krahas polisemisë edhe monosemia duhet të trajtohet si objekt i semantikës. Ajo duhet të shqyrtohet njësoj si sistemet semantike themelore: polisemia, homonimia, antonimia e sinonimia, jo vetëm për vlerën që shfaq, por edhe si element plotësues i sistemit themelor të semantikës.

Përfundime:

Monosemia (njëkuptimshmëria) është më e gjerë sesa e supozojmë. Shembujt e dhënë më lart tregojnë jo vetëm rrugët e përfuturit të monosemisë, por edhe faktin se kjo dukuri duhet të meritojë më tepër vëmendje dhe jo trajtime teorike të përcipta. Dukuria e monosemisë duhet të shqyrtohet më së shumti si një realitet gjuhësor dhe jo thjesht një çështje leksikografike. Pavarësisht se vjelja e materialit është marrë për efekt krahasues nga fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe, qëllimi është për të dhënë ndihmesë për një qasje ndryshe ndaj dukurisë së monosemisë.

Nga evidentimi i materialit në fjalorët shpjegues të shqipes, vërejmë se dukuria e monosemisë ka shënuar rritje të vlerës saj. Ka disa mënyra për përfuturit e dukurisë së monosemisë:

-huazimi i fjalëve nga gjuhë të tjera; hyrja e njërive leksikore nga fusha e terminologjisë; zbulimi dhe përthithja e leksikut popullor, duke u mbështetur te prurjet e krahinorizmave; lëvizjet dhe ndryshimet e strukturës përmbajtjesore të fjalës, janë mundësi të konsiderueshme për shtimin e fjalëve monosemantike.

Në këtë mënyrë e konsiderojmë monoseminë një dukuri, e cila tashmë është fakt dhe meriton interes në trajtimin teorik gjuhësor, ashtu si elementet e sistemit themelor semantik.

## **Bibliografia**

- A.Kostallari, "Parimet themelore për hartimin e "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe", në "Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe", Tiranë 1972.
- Ch.Ruhl, "On monosemy. A study in linguistics semantic", 1989, University of New York Press.
- "Fjalor i gjuhës së sotme shqipe", Tiranë 1980.
- "Fjalor i gjuhës shqipe", Tiranë 2006.
- Henri Bejoint, "Monosemy and dictionary", (3rd EURALEX International Congress), 1988.
- J.Thomai, "Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe", fq.77, Tiranë 2009.
- J.Thomai, "Leksikologjia e gjuhës shqipe", Tiranë 2011.
- Nick Riemer, "The semantic of polisemy", Cognitive Linguistic Research, 2005 "
- R.Memushaj, "Hyrje në gjuhësi", Tiranë 2014.
- V.R.Verhoeven, "The organization of the mental lexicon", Utrecht University, 2017.
- Sally A. Rice, "Polisemy and lexical representation", University of Alberta. New Jersey 1992.
- Th.A.Janssen, "Monosemy vs polisemy", Cognitive Approaches to Lexical semantics, 2006.